

VENDIM
Nr. 252, datë 25.3.2015

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË SHTETIT TË KUVAJTIT, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E ZHVILLIMIT
TË EKSPORTEVE INDUSTRIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Kuvajtit, për bashkëpunimin në fushën e zhvillimit të eksporteve industriale, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË SHTETIT TË KUVAJTIT NË FUSHËN E ZHVILLIMIT TË EKSPORTEVE
INDUSTRIALE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Shtetit të Kuvajtit, mëposhtë të quajtura “Palët Kontraktuese”:

duke synuar forcimin e lidhjeve vëllazërore dhe bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve vëllazërore;
nxitjen e marrëdhënieve ekonomike dhe industriale midis dy shteteve;
bazuar në dëshirën e përbashkët për të zhvilluar bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve në fushën e zhvillimit të eksporteve industriale,
kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1

Të dyja Palët Kontraktuese bien dakord që të bëjnë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të zhvilluar dhe lehtësuar shkëmbimin tregtar ndërmjet shteteve të tyre përkatëse.

Neni 2

Autoritetet kompetente për zbatimin e këtij Memorandumi janë:

Për qeverinë e Shtetit të Kuvajtit:

Autoriteti Publik për Industrinë (*Kuwaiti Industrial Export Development Center KIEDC*)

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Ministria përgjegjëse për çështjet ekonomike.

Neni 3

Të dyja Palët Kontraktuese dotë shkëmbejnë informacionin e mëposhtëm:

-Informacionin ekonomik dhe industrial, buletinet, botimet periodike dhe çdo informacion tjetër

tregtar dhe industrial, që lidhet me to dhe që është botuar në shtetin e tyre;

- Të dhënat kompjuterike në lidhje me tregtinë e jashtme;
- Rregulloret dhe procedurat në lidhje me tregtinë e jashtme;
- Statistikat tregtare.

Neni 4

Të dyja Palët Kontraktuese do të bashkë-punojnë për identifikimin dhe diskutimin e zonave të potencialeve të eksportit, duke ndërmarrë veprimet e nevojshme, me qëllim rritjen e tregtisë përfituese dypalëshe ndërmjet shteteve të tyre përkatëse dhe mundësinë e themelimit të komisioneve të përbashkëta dhe forumeve e takimeve të punës, për të lehtësuar studimet mbi tregjet kombëtare dhe /ose tregjet e vendeve të tjera me interes të përbashkët.

Neni 5

Të dyja Palët Kontraktuese dotë sigurojnë lehtësirat e mundshme në fushat e mëposhtme:

- Pjesëmarrje në panaiet ndërkombëtare dhe ekspozitat e specializuara të zhvilluara në të dyja shtetet;
- Pjesëmarrje në seminarët mbi tregtinë dhe në veprimtari të tjera, ku mund të demonstrohen produktet, shërbimet dhe kapacitetet tregtare të secilit vend;
- Shkëmbim i vizitave të delegacioneve ndër-mjet dy vendeve përkatëse.

Neni 6

Të dyja Palët Kontraktuese do të bashkë-punojnë në organizimin e programeve të trajnimit për stafet e tyre për të përfituar nga njohuritë e posaçme që lidhen me aktivitete dhe teknikat e nxitjes tregtare, si dhe për shkëmbimin e ekspertëve të rënë dakord ndërmjet dy palëve.

Neni 7

Nëse Palët Kontraktuese nuk mund t'u përgjigjen kërkesave të njëra-tjetrës, ato do të bëjnë përpjekjet e tyre të mundshme duke u rekomanduar organeve të tjera përkatëse që të përmbushin këto kërkesa.

Neni 8

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e Memorandumit do të zgjidhen në rrugë miqësore nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 9

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi që nga data e njoftimit të fundit, ku njëra nga Palët informon me shkrim Palën tjetër, nëpërmjet kanaleve diplomatike se i ka përmbushur procedurat institucionale për hyrjen e tij në fuqi.

Ky Memorandum mund të amendohet me miratimin e të dyja palëve; amendimet dotë jenë në fuqi sipas procedurave të përmendura në paragrafin e mësipërm të këtij neni.

Ky Memorandum është i vlefshëm për një periudhë katërvjeçare dhe do të rinovohet automatikisht për të njëjtën kohëzgjatje, përveç kur ndonjë nga palët njofton nëpërmjet kanaleve të saj diplomatike në lidhje me qëllimet e saj për përfundimin e marrëveshjes, gjashtë muaj para përfundimit të afatit të saj.

Bërë në Kuvajt Siti, më 19 nëntor 2014, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretim,

teksti në gjuhen angleze do të këtë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë
Arben Ahmetaj

Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Për qeverinë e Shtetit të Kuvajtit:

Anas Al-Saleh

Ministër i Financave